

SI KËQYRET NJË EKSPozITË?

DIANA MALAJ

Diana Malaj është një nga themelueset e Grupit ATA me qendër në Kamëz, si dhe redaktore e gazetës lokale të themeluar nga kolektivi, Nyje.al. ATA përdorin një qasje shumëdisiplinore në veprimtarinë e tyre, duke shfrytëzuar forma e mjete të huazuara nga lëmet e aktivizmit, artit, etnografisë, gazetarisë dhe ligjit, për të trajtuar çështjet politike, mjedisore dhe të të drejtave të njeriut që prekin komunitetet e skajuar dhe të diskriminuara.

Nxitimthi, si gratë pas një pune të kryer që tentojnë të mos e humbasin të radhës, ashtu nisemi nga Kamza për të mos e humbur, për herë të dytë ekspozitën *Synime* në Prishtinë. Në ditën e saj të fundit dhe të fundit të qershorit, me tendosjet e kohës së pamjaftueshme, me ndjesinë që je gjithnjë thuajse vonë, kurrë me mundësinë për të menduar vonesën. Si çdo lëvizje tjetër që na del jashtë përditshmërisë sonë, si çdo përpjekje që s’lidhet me punën, me detyrimet, me detyrat, na

kushton stërmundim. Ndjenja e detyrës na e mundëson më lehtë kryerjen e punës. Më kollaj kryhet puna, sesa dëshira.

Në orët e mëngjesit, në pasdrekë e në pasditet e vona, nëse do të qëndronim para stacioneve të para të urbanëve të Kamzës, me kuadrin nga rruga, me derën e urbanit për kornizë, do të shihnim nxitimin e grave, të cilat nuk e kanë shansin ta humbasin as edhe një autobus të linjës nga puna në shtëpi. Sado përplot të jetë. Zatetja ndjehet më pak në lëvizje, pritja nuk arsyetohet. Një dinamikë e fortë e shoqëron imazhin e tyre (tonin) nga nxitimi me çanta dhe rroba (si të jenë duke nxituar për të dhënë ndihmën e shpejtë diku) në pezulltinë si bust para xhamit të autobusit me shikimin e përhumbur jashtë dritares. Si të mos mjaftonte ky tensionim i kontrastit mes nxitimit e pezulltisë, sytë tanë do të kapnin, aty-këtu, edhe spazmat fizike – si një muskul i tendosur në fytyrë – të lëna nga fabrika, shtëpia a kudo qoftë vendi ku angazhohen. Janë këto gratë tona, me të cilat duam të flasim e të na flasin, mes punës në shtëpi e punës tjetërkund, kudo qoftë diku tjetër. Teksa futemi në ekspozitë, duam s’duam, gjykimet, mimikat, reagimet dhe shikimet e tyre i kemi me vete. Jemi kureshtare të shohim sesi këto gra, ne dhe artistet, do të flasin me njëra-tjetrën për ekspozitën, madje, më së pari, nëse do të arrijnë të flasin.

Gratë artiste që ne njohim janë ato të cilat na janë qasur në Kamëz dhe janë shprehur të gatshme të bashkëpunojnë me ne, ose që i kemi ftuar në projekte artistike, më së shumti performative. Mund të numërohen me gishtat e njëjës dorë, të cilat sapo i numërojmë, i shtrëngojmë fort e shpejt që të mos “na ikin nga duart”. Te poezia, teatri, letërsia, fotografia na ka drejtuar trupi ynë i pagojë, gjithmonë si “tjetra” e pagjuhë, e

Si këqyret një ekspozitë?

pazë, e mohuar. Falë tyre jemi çelur e jemi shprehur dhe ia dimë forcën që mbartin kudo ku ushtrohen. Mirëpo, në Kamëz ku ndodhemi ne, vepra të tjera artistike, aq më pak grash, rrallë kanë mbërritur si ndërhyrje dhe nisma institucionale. Ne jemi të vetëdijshme se gratë e Kamzës dhe ekspozita *Synimet* nuk do të takoheshin kurrë në Kamëz. Kamza nuk e ka një galeri arti dhe ekspozita duket sikur është e bërë vetëm për galeri arti. Skena e kulturës në Kamëz nuk e ka as privilegjin e historikut të një vatre kulture të socrealizmit, pasi qyteti është krijuar pas ndryshimit të regjimit dhe qëndron si rast studimor shembullor, për të parë sesi ndërtohet qyteti post socialist në Shqipëri. Edhe ai pallat kulture i ndërtuar (2011), i cili i ka të gjitha hapësirat e mundshme për t'u hapur ndaj artistëve, qofshin të artit pamor apo performativ, i ka aq të ngjeshura historitë e zaptimit institucional, sa mundet kështu nga këto nënshtresëzime padrejtësish t'ia nisim me historinë e artit dhe kulturës në Kamëz.

Fillimisht, dhe përgjatë 8 viteve të para, ky institucion është (keq)përdorur nga ish-drejtuësit e bashkisë (të Partisë Demokratike) për mbledhje elektorale dhe festivale vjetore folklorike. Pas marrjes së pushtetit (pa legjitimim) nga Partia Socialiste në bashkinë Kamëz, pallati i kulturës i jepet disa prej drejtorive vendore të bashkisë, si: ujësjellës-kanalizimeve, medieve, shërbimeve tregtare e sociale, bareve e kafeve dhe dy bankave. Kështu, dhoma e regjisorit rriemërtohet në zyrë e drejtorit të UKK-së, dhoma e aktorëve në zyrën e financës, medias, IT-së etj. Pallati i kulturës kthehet në pallatin e kulturës së ujësjellës-kanalizimeve. Fijet ngatërrohen, dyert e tij të çojnë kudo tjetër, por jo te kultura. Tashmë, e vetmja derë që ka

mbetur për t'u drejtuar te kultura, të çon te vendi i vaksinimit, ku burra e gra, me mëngët e përveshura dhe me pak pambuk, kapen, thuajse në turp, teksa përballen me shikimin e një kalimtari, që sapo ka hyrë në kërkim të bibliotekës së qytetit. Çka na serviret si hapësirë publike, na merret mbrapsht si private. Institucioni publik del të jetë i mbyllur hermetikisht ndaj publikut dhe lehtësisht i privatizueshëm. Kjo na bëhet në mes të ditës. Me këtë përvojë periferike shohim e na duken po aq periferike edhe institucionet qendrore, mënyra sesi shembet një teatër kombëtar e buxheti nën nivelin e modestisë që ka një galeri kombëtare. Me sytë e periferisë, kombëtarja na shfaqet tepër lokale. Dhe këtu aktivizmi ndeshet me limitet e veta. Për ta çuar më tutje, na ka ardhur në ndihmë aksioni krijues, që ka huazuar shumëçka nga arti, por art në vetvete nuk e kemi emërtuar kurrë.

Mbi ekspozitën

Teksa i marrim me vete gratë e qytetit tonë, pa gjuhën për të treguar se ku dhemb, pa përgjigje ndaj gjendjes së tyre, me ndjesinë e të qenit midis punëve, ku koha e vetme e lirë me veten është ajo që mbulon hapësirën nga njëra punë te tjetra, futemi në ekspozitë. Ekspozita *Synime* u hap më datë 01.02.2021 dhe u mbajt e hapur deri më 1.04.2021 në Galerinë Kombëtare të Arteve (Tiranë), dhe më datë 30.04.2021-30.06.2021 në Galerinë Kombëtare të Kosovës (Prishtinë). Ekspozita u kurua nga artistet e kuratorët Adela Demetja dhe Erëmirë Krasniqi dhe paraqiste një mori veprash të artisteve

shqiptare për një periudhë afro 70-vjeçare krijimtarie.¹

Në udhëtim drejt Prishtinës jemi 4 vajza aktiviste të Grupit Ata. Mariana dhe Mira janë tek të njëzetat, dhe të dyja janë bërë pjesë e grupit që në adoleshencë të tyre. Secila prej tyre është angazhuar në Teatrin e Atyre, një nga praktikat më të rregullta të sprovuara nga Grupi Ata dhe regjisorë (rishtarë apo profesionistë si Ergys Malësia me dy vepra teatrale dhe Anila Balla me gjashtë vepra teatrale) që prej themelimit. Asnjëra prej tyre nuk ka pasur role të lehta. “Prostituta” e Dario Fo-së dhe “E përdhunuar” e Franca Rames ua ka latuar disi portretin e fytyrës, tonet e zërit. Interpretimi i këtyre dy roleve nga dy vajzat tona ua ka thelluar marrëdhënien me veten.

Ato nuk flasin shumë gjatë udhëtimit. Po aq të heshtura qëndrojnë gjatë ekspozitës. Edhe pas saj, edhe pas përpjekjes sonë për të folur me to, për të nxjerrë prej tyre ndonjë koment. Në komunikime telegrafike na thujse-premtohej një skicë a dytri fjalë për përjetimet e ekspozitës. Sot e kësaj dite, ajo çka pritëm mbeti si një përvojë e ftohtë. Ndërsa Aurora, bashkëthemeluesja e Grupit Ata, dhe bashkudhëtarja jonë, i ndjek veprat duke i gjykuar për nga ngjyra dhe jo emrat e autoreve.

¹ Artistet që kanë marrë pjesë në ekspozitë janë (renditja emërore e artisteve është marrë nga publikimi informues i ekspozitës): Silva Agostini, Brigita Antoni, Bora Baboçi, Alma Bakiaj, Lumturi Blloshmi, Lirije Bulliqi, Liljana Çefa, Donika Çina, Flaka Haliti, HAVEIT, Blerta Hoçia, Majlinda Hoxha, Shpresa Faqi, Fitore Isufi-Koja, Shelbatra Jashari, Ledia Kostandini, Edona Kryeziu, Hyrije Krypa, Iva Lulashi, Diana Miziri, Silvi Naçi, Matilda Odobashi, Greta Pllana, Edit Pula, Nurhan Qehaja, Alketa Ramaj, Miradije Ramiqi, Anila Rubiku, Merita Selimi, Marina Sula, Alije Vokshi, Eli Xoxa, Alketa Xhafa Mripa, Rudina Xhaferi, Violeta Xhaferi, Androniqi Zengo Antoniu, Sofia Zengo Papadhimitri, Valbona Zherka.

Për brezin tonë, të rritur në këtë qytet, veprat e ekspozuara në *Synime* dhe artistet e tyre janë pothuajse të huaja. Janë të shumta artistet që nuk ua kishim dëgjuar emrin më parë. Nuk ua njihnim praktikat dhe veprat. Teksa i shohim në varg njëra pas tjetrës nuk ua kuptojmë për kollaj gjuhën dhe synimet. Na duhet të improvizojmë hedhjen e shikimit dhe të hapave mes tekstit kuratorial, veprës dhe asaj të radhës, në tentativën për të stabilizuar ndonjë ndijim, mendim a kuptim. Trupi ndihet i çorientuar në hapësirë dhe mendimi para veprës. Pamundësia për t'u ulur mes tyre e vështirëson edhe më shumë qëndrimin, duke vazhduar të na e mbajë ndjesinë e rendjes nga njëra te tjetra. Gjuhët, ngjyrat dhe format e tyre duken të ndryshme, madje edhe brenda përbrenda secilës autore, duke e bërë të vështirë identifikimin e veprës me krijuesen. Tentojmë t'i kujtojmë vetes se duhet durim, pak më shumë kohë, dhe një shans i dytë që duhet t'i jepet secilës vepër në shenjë mirësjelljeje. Ama, e vërteta është se nuk ndihemi publiku i saj. Ose më saktë, ndihemi publiku në faj i një ekspozite. Faj që s'kemi lexuar pak më shumë, që s'kemi parë pak më shumë, që s'i krijuam kohë paraprakisht pak më shumë kësaj ekspozite. Po artistet, përse s'i njohim? Përse nuk i ndjekim? Pse nuk e përballim veten me troje ekspozuese, jashtë përditshmërisë sonë, larg vendbanimit tonë? Asnjë përgjigje brenda nesh nuk na justifikon.

Dhe të njëjtat pyetje qëndrojnë për anën tjetër. A na mendon ekspozita ne si publikun e saj? A e synon ekspozita fajësimin tonë? A e ka menduar ekspozita narcizmin negativ që do e quante Judith Butler, vetëfajësimin tonë të vazhdueshëm, si e vetmja mënyrë për t'u mbajtur pas vetes, duke e kritikuar

Si këqyret një ekspozitë?

pareshur atë? Çfarë do t'i thotë ekspozita një publiku që nuk ka lexuar e parë pak më shumë vepra artistike paraprakisht? Si ndihet ajo që gratë e periferisë i ka kaq larg e kaq të huaja? A ndihet ajo në faj siç ndihemi ne që nuk e njohim atë?

Po nëse ekspozita, artistet, kuratorët, Galeria Kombëtare apo institucionet përkasni do të kishin pasur qasje tjetër? Po sikur të ishin ekspozuar jashtë kontureve të stabilizuara tashmë, të njohura e të lodhura të institucioneve, në troje të tjera, gjeografi të tjera që nuk (i) njohin prekje të tilla?

E vazhdojmë këqyrjen e ekspozitës. Si mjet për kërkimin e provës. Me gjithë ngarkesën e padijes, vepra e artit na ngatërrohet me gjuhë të tjera ekspertizash. E shohim imtësisht, a thua se po kërkojmë të gjejmë gjurmët e një veprë “penale”. Cilat janë gjurmët e veprës së artit? Po pasojat materiale të saj? Çfarë gjendjeje përshkruan ajo vepër? A ia dalim të saktësojmë mënyrën, kohën, shkaqet e ndryshimeve që mund të kenë ndodhur tek artistja? Si bëhet këqyrja e një ekspozite? Sa invaziv është shikimi i pastërvitur i yni mbi vepra që, herë-herë, na duken vulnerabël përpara nesh, përpara çdokujt. Si këqyret një ekspozitë? Si mund të vazhdoj ta këqyr ekspozitën pa menduar për vajzat? Si po e këqyrin ato? Meqë është e vështirë të hiqet një konstante mes veprave, atëherë heqim dorë nga dëshira për të stabilizuar ndonjë ide. E kuptojmë ama që ekspozita *Synimet* kërkon t'i rezistojë idesë thjeshtëzuese të artit të grave, me ide esencialiste. Janë shumë gra artiste dhe secila është krejt e përveçme, individuale, e papërsëritshme. Nuk mundesh kurrsesi t'i zatetësh me një ide të vetme, përpos përpjekjes me nxjerrë në pah veprimtari artistike, thuajse 70-vjeçare, nëpër institucione të cilat kanë promovuar

më së shumti punën e burrave.

Në këtë moment përfshihem në një lloj loje të veprës, një lloj loje e artistes me publikun, ku publiku ftohet të pyesë sesi e ka bërë autorja veprën, se çfarë materialesh e mjjetesh ka përdorur, me çfarë teknike ka mundur t’i bëjë bashkë ato. Një qasje e tillë duket sikur më shumë tenton të shtrojë pyetje mbi procesin e punës sesa mbi produktin final të saj, si të ishte një ftesë empatike shtruar tjetrit, duke i thënë “hajde në studio dhe shih si punoj”. Duket si synim për ta mbajtur veten mes materialit dhe veprës, për të qëndruar aty në mes dhe për të ndërtuar një shteg, i cili të fut pikërisht në këtë mes. Një kërkesë e tillë duket si një kërkesë për t’i njohur punën krijueses, për t’ia parë mundin dhe imagjinatën në praktikë e sipër. Një qasje e tillë artizanale, ku krijuesja si vepër sheh procesin prodhues, performativiteti i të krijuarit si vepër, mobilizimi i artit pamor, galerisë dhe ekspozitave për t’i instrumentalizuar në funksion të nxjerrjes në pah të vetë praktikave të shfaqjes, punës e të transformimit të gjërave përmes trupave dhe imagjinatës. Dhe këtu ndjej një pikëtakim me këto krijuese, të cilat i ndjej më shumë si punëtore sesa si artiste, ashtu siç ndjej edhe veten.

Rikujtohem për vajzat. Si po e këqyrin ato ekspozitën? Afrohemi, largohemi. Gjysmë reagime. “Ngjyrat janë të bukura” – themi nën zë teksa shohim veprën *Papastërti* (2019) të Alketa Ramajt. Një vepër të cilën, më pas, duke e lexuar në tekst kuptojmë se çfarë na çoi tek ajo. Trupat tanë, si copa tekstili industrial kanë thithur nuancat në gri të nënave tona, duke dalë në pah ne, me identitete jo fort të reja, jo krejt të tjera, në hapësira gjeografike, që janë tepër larg asaj çka ëndërrojmë. “Këtë do të kisha zgjedhur unë” – Mariana drejton me gisht

Si këqyret një ekspozitë?

veprën *Kam qëndruar shumë brenda kokës* (2020), e artistes Alma Bakiaj. Ajo qëndron e ulur gjatë, duke i parë nga njëri kënd e përkundruall, sa e tërhequr në veten e saj, sa në përpjekje të vazhdueshme për të komunikuar me ne. Ndjej që ndjen njëfarë tensioni gjuhësor mes e përreth nesh. Mirën e ndjek me sy, kalon lehtë nëpër ekspozitë. Herë pas here ndalet më gjatë, me kokën e zhytur më afër emrit të autores. Lëviz. Ajo vetë pikturon. Një talent i saj aspak i ekspozuar, herë-herë i shtypur me lehtësinë që vetëm prindërit tanë dinë ta bëjnë me shprehje “ça po të duhet...”, teksa sugjerojnë një degë studimi për financë a administrim biznes.

Në praktikën tonë si grup, përmes etnografisë dhe artit kemi synuar që atë traditë kuptimore, e cila na është mësuar si urdhër, ta përthyejmë për të thënë diçka të re përmes tyre dhe, po ashtu, në lidhje me to. Një qasje e tillë, në dukje modeste, që merr një traditë – të cilën do mund ta konsideronte edhe armike – dhe e përthyen në një mënyrë të tillë, sa të krijojë një vepër artistike përmes saj, na ngjan se është një shteg shumë prodhimtar për artin dhe me valencë bukurshumë politike. Nga njëra anë, loja me traditën tregon se e njohim mirë atë, duke prerë mundësinë për t’u trajtuar si të huaja përbrenda kontekstit kulturor, i cili na ka qëndruar mbi kokë gjithnjë dhe, nga ana tjetër, provokimi i blasfemisë së të instrumentalizuarit të kësaj tradite, për të nxjerrë më në pah presupozimet mbi të cilat mbahet ajo, ose për të thënë diçka të re përmes saj, por edhe përkundër saj.

Marrim sërish kohë për të riparë disa prej veprave. “Sikur më vjen më afër si vepër” – flasim sërish me njëra-tjetrën, disi të lehtësuara kur vepra na bëhet pak më e qartë,

teksta shohim *Ëndrrat e qepura* (2004) të artistes Anila Rubiku. Në fund drejtohem për tek dhoma e vogël e errët. Në aq pak raste që kemi vizituar ekspozita, dhoma e errët është si shpresa e fundit. Sikur të parapërgatit për diçka që s'ke nga shkon pa e dashur, pavarësisht nëse e kupton apo jo. *Current state* (2014) e Silva Agostinit na mbërthen. Trupi që lëviz, që dridhet e kërcen. Trup i zënë në ngërç, në çlirim e sipër, me një rezistencë që nuk kuptohet nëse po tenton të ndrydhë një shtysë të brendshme që do të shpallet apo po tenton t'i shpëtojë zinxhirëve që e mbajnë lidhur së jashtmi. E shoh, dal. I ftoj vajzat, disi me insistim, sikur për t'u dhënë forcë, edhe pak, mos e humbisni durimin. E shohim bashkarisht. Trupi në video-performancë na flet me gjuhën tonë. Me gjuhën e trupit. Gjendja trupore e rënduar flet njësoj për të gjitha ne. E njohim mirë alfabetin e tij. Në trup ne arkivojmë peshën e gjykimit, ndrydhjes dhe shtypjes. Trupi na e ndjen më së pari stërmundimin e gjuhës, të të shkruarit, të shfaqjes. Është trupi që na e përjeton, në radhë të parë, mundin e të të krijuarit dhe e të thënit të diçkaje të re nga fillimi. Është trupi i Mirës, si aktore, që përjeton ndërhyrjen e ashpër të burrit nga Valiasi për të ndërprerë shfaqjen “Vidh një çikë më pak”; është trupi i Marianës që na rrëfen historinë e përdhunës si akt hakmarrjeje nga tekstura auto-referenciale e Franka Rames; është trupi i Aurorës dhe imi që, si segmente të fragmentuara, emërtohem prej vitesh me tre shkronja të alfabetit, *ata*. Dalim nga dhoma e zezë dhe ekspozita e nisemi menjëherë për në Kamëz. Emrat dhe punën ua njohim tashmë grave artiste, synimet e tyre më pak. Më shumë sesa t'i marrim me vete, na duket se i kemi lënë diku duke punuar; më të vështira të mbahen me vete sesa gratë e

Si këqyret një ekspozitë?

Kamzës dhe të fabrikave të përmendura në krye të herës. Na duket se duhet më shumë punë nga të dyja anët për të krijuar vende të reja, për t'i parë punët e tyre dhe për të folur më shumë për synimet e ndryshme që kemi.



Fig. 1. *Synime*, Prishtinë (prill 2021), pamje e ekspozitës, fotografi e realizuar nga Majlinda Hoxha. Riprodhuar me lejen e autores dhe të Galerisë Kombëtare të Kosovës.



Fig. 2. *Synime*, Prishtinë (prill 2021), pamje e ekspozitës. Fotografi e realizuar nga Majlinda Hoxha. Riprodhuar me lejen e autores dhe të Galerisë Kombëtare të Kosovës.

Si këqyret një ekspozitë?



Fig. 3. *Synime*, Prishtinë (prill 2021), pamje e ekspozitës. Fotografi e realizuar nga Majlinda Hoxha. Riprodhuar me lejen e autores dhe të Galerisë Kombëtare të Kosovës.



Fig. 4. *Synime*, Prishtinë (prill 2021), pamje e ekspozitës. Fotografi e realizuar nga Majlinda Hoxha. Riprodhuar me lejen e autores dhe të Galerisë Kombëtare të Kosovës.



Fig. 5. *Synime*, Prishtinë (prill 2021), pamje e ekspozitës.
Fotografi e realizuar nga Majlinda Hoxha. Riprodhuar me lejen e autores dhe të Galerisë Kombëtare të Kosovës.